**VENDIM**
**Nr. 135, datë 6.6.2022**

**MBI KËRKESËN PËR LICENCIM TË SHOQËRISË "SALILLARI ENERGY TRADE" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 67 ,të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 866/4 prot., datë 2.6.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Salillari Energy Trade' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 20.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE, me shkresën nr. 70/13 prot., datë 22.4.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.5.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 469/1 prot., datë 27.4.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Duke qenë se dokumentacioni plotësues i depozituar nga shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/3 prot., datë 11.5.2022, nuk plotësonte tërësisht kërkesat e rregullores, ERE iu drejtua shoqërisë sërish me shkresën nr. 469/4 prot., datë 18.5.2022.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 495/6 prot., datë 24.5.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.
- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me qëllim sqarimin/dokumentimin e informacionit plotësues të sjellë nga shoqëria si dhe depozitimin në ERE të vërtetimit të prokurorisë për administratorin e saj, vlerësohet e arsyeshme që shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të paraqesë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentet e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të paraqesë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentet e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**